



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 01, Datë 08.01.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” SH.P.K. PËR RINOVIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.01.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2983/1 prot., datë 29.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.06.2021, deri më 24.06.2026
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2983/1 prot., datë 24.12.2025.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 490 Seria T21, është 24.06.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 24.12.2025.
- Sa konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të Rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Shoqëria ka bërë me dije se nuk ka patur ndryshime thelbësore të dokumentacionit dhe të dhënave teknike të dokumentacionit të depozituar në aplikimin fillestar për pajisje me licencë.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se shoqëria “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. ka paraqitur ekstraktin historik të QKB-së, vërtetimet e gjendjes gjyqësore për administratorin dhe shoqërinë, si dhe vërtetimin tatimor, nga të cilat konstatohet përmbushja e kriterëve përkatëse. Shoqëria ka depozituar strukturën administrative dhe pasqyrat financiare të audituara për vitet 2022–2024, nga të cilat rezulton se ka qenë me fitim për të tre vitet kontabël.
- Nga vlerësimi i dokumentacionit rezulton se shoqëria ka depozituar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores, ndërkohë që mbetet për t’u depozituar dhe/ose plotësuar dokumentacioni përkatës.
- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se nga ana e saj duhet të sqarohet/plotësohet dhe sa vijon:
 - *deklaratën e kërkuar në gjurmën “c” të Shtojcës 1 të rregullores;*
 - *vërtetimin se shoqëria nuk ka detyrime tatimore të papaguara;*
 - *parashikimin e sasisë së energjisë që do të tregtojë 5 vitet e ardhshme të ushtrimit të aktivitetit, mënyrën se si parashikon ta financojë këtë veprimtari në të ardhmen e po ashtu dedikimin e mbështetjes financiare përkatëse.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 490, Seria T21, të shoqërisë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI